



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:205694

Datë: 06.08.2024

Numri i dokumentit: 06025368

C.nr.947/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoreshen profesionale Adelina Çmega, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses K me seli në Prishtinë, Distrikti në Gjakovë, të cilën sipas autorizimit e përfaqësojnë A.M dhe T.G, kundër të paditurit N.M.H nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, me bazë juridike kompensimin e dëmit material, vlera objektit të kontestit 77.57 euro, pas shqyrtimit kryesor të mbajtur më datën 30.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditëses K me seli në Prishtinë, Distrikti në Gjakovë, me të cilën ka kërkuar që të “DETYROHET i padituri N.M.H nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, paditëses të i paguaj dëmin e shkaktuar material në shumën prej 77.57 euro, dhe atë me kamatë ligjore 8% nga data 14.09.2021 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.”

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja K me seli në Prishtinë, më datën 14.09.2021, në këtë gjykatë ndaj të paditurit N.M.H nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, ka parashtruar padinë për kompensimin e dëmit material në shumën prej 77.57 euro. E njëjta, përmes të autorizuarve të saj ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, me propozimin që gjykata kërkesëpadinë e saj ta aprovojë në tërësi si të bazuar, me arsyetimin se me të gjitha provat e administruara nga gjykata gjatë shqyrtimit kryesor, kërkesëpadia e saj është provuar si e themeltë.

Paditësja më tej ka shtuar se: mbesim në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë në vlerë prej 77.57 Euro, dëm ky i shkaktuar nga i padituri, si pasojë e veprës penale nga neni 314 i KPRK-së. I padituri, me aktgjykimin me numër P.nr.320/2020, të Gjykatës Themelore Gjakovë-Dega në Rahovec, është shpallur fajtor për veprën penale, lartësia e dëmit vërtetohet me faturën e kalkulimit të rikthimit të humbjeve me numër 286581, të datës 17.01.2020, ku shihet se llogaritja e dëmit është bërë në bazë të pajisjeve të cilat i ka pasur i padituri në momentin e konstatimit të keqpërdorimit të energjisë elektrike. Llogaritja e dëmit në mjete monetare sipas faturës me numër DGJHP209002, të datës 17.01.2020, është bërë në pajtueshmëri me Rregulloren për Procedurën

për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar të Energjisë Elektrike, ku të paditurit nga momenti i konstatimit të keqpërdorimit të energjisë elektrike i është llogaritur për 6 muaj në mënyrë retroaktive. Sa i përket pretendimeve të cekura nga përfaqësuesi i të paditurit, të njëjtat nuk qëndrojnë për faktin se paditësja ka ushtruar kallëzim penal ndaj të paditurit N.H me numër personal ..., si shfrytëzues i shifrës me numër DGJ9030915, ku lidhur me pretendimet me kallëzimin penal i padituri është shpallur fajtor me aktgjykimin me numër P.nr.320/2020, ndërsa sa i përket propozimit për dëgjimin e dëshmitarëve, të njëjtin propozim e kundërshtojmë për faktin se lidhur me pretendimet e të paditurit, veprimet e të paditurit janë vërtetuar në bazë të aktgjykimit të cekur më lart, i cili aktgjykim është edhe i formës së prerë që nga data 30.08.2021, andaj konsiderojmë që dëgjimi i dëshmitarëve është i panevojshëm dhe veç se do të bënte prolongimin e procedurës dhe do të krijonte shpenzime shtesë. Sa i përket provës të cilën e dorëzoi i padituri, e njëjta provë nuk ka të bëjë me këtë çështje kontestimore, pasi që i padituri ka shkaktuar dëm në shifrën me numër 903915, si shfrytëzues i kësaj shifre, andaj një provë e tillë nuk është relevante në këtë çështje kontestimore, pasi që i njëjti mund të posedojë disa njehsorë. Andaj i propozojmë gjykatës që pas shqyrtimit dhe administrimit të provave padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar, si dhe ta obligojë të paditurën në pagesën e shpenzimeve të taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00 Euro.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurit av. A.M më tej ka shtuar se: Mbesim pranë përgjigjes në padi të datës 08.04.2024, ashtu që i padituri e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë, e njëjta nuk ka bazë ligjore pasi që i padituri nuk posedon këtë orëmatës, mirëpo këtë e shfrytëzon vëllai i tij G.H.H dhe i gjithë ky gabim ka ndodhur nga zyrtarët e paditëses, e të cilin e ka vazhduar edhe e paditura, e cila është kontradiktore, sepse kallëzimi penal është ngritur ndaj G.H.H dhe të gjitha provat e bashkëngjitura kallëzimit penal, si fotografitë dhe vlerësimi i dëmit është bërë në shtëpinë e G.H.H dhe jo palës së paditur, sepse i njëjti në fotografi shihet se vëllai i tij G.H posedon një stallë të bagëtive dhe shihet disa pajisje bujqësore, e të cilat nuk i posedon i padituri në këtë rast. Po ashtu, i padituri me aktgjykimin e lartcekur 320/2020, është shpallur fajtor dhe i është shqiptuar urdhri ndëshkimor, po ashtu gabimisht dhe pa asnjë bazë ligjore. Urdhrit ndëshkimor të cilin pala nuk e ka pranuar asnjëherë, sepse me urdhër ndëshkimor ishte vërtetuar gabimisht identiteti i palës si N.M.H, ndërsa i njëjti është N.H.H, andaj nga të gjitha këto kërkoj që padia e paditëses të refuzohet si e pabazë dhe të hedhet poshtë. Propozoj të dëgjohen si dëshmitarë zyrtarët të cilët kanë përpiluar procesverbalin dhe atë: L.M dhe N.D. Gjykatës do t'ja dorëzoj disa prova, si: Transaksionet e konsumatorit, me numër të orëmatësit DGJ80014432, në emër të N.H.H t, i cili është pronar dhe shfrytëzues i vetëm këtij orëmatësi.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave:

1. Aktgjykimi P.nr.320/2020, Gjykatës Themelore Gjakovë, Dega në Rahovec, i datës 18.01.2021, i plotfuqishëm nga data 30.08.2021.
2. Njoftim me nr. rendor 00000 i Departamentit Ligjor – zyrës Ligjore në K, i datës 21.07.2021.
3. Kalkulimi RH, me ID të rastit, 286581 i datës 17.01.2020.
4. Fatura DGJHP 209002, e datës 17.01.2020.

5. Transaksionet e konsumatorit në orën DGJ-80014432, me shfrytëzues N.H.H.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se i padituri N.H, ishte konsumator i kompanisë K. Gjithashtu nuk ishte kontestues as fakti se ndaj të me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Gjakovë-Dega në Rahovec, me numër P.nr.320/2020, i datës 18.01.2021, i plotfuqishëm nga data 30.08.2021 është shpallur fajtor për veprën penale vjedhja e shërbimeve nga nenin 314 par.1 lidhur me par.6 të KPRK-së.

Kontestuese në këtë rast ka qenë baza juridike dhe lartësia e kërkesës.

Me administrimin e aktgjykimit P.nr. 320/2020, të datës 18.01.2021, i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, i cili është i plotfuqishëm nga data 30.08.2021, gjykata e ka vërtetuar faktin se i padituri N.H është shpallur fajtor për veprën penale vjedhja e shërbimeve nga nenin 314 par.1 lidhur me par.6 të KPRK-së. Gjykata i fali besimin kësaj prove tërësisht pasi që i njëjti është aktgjykim i plotfuqishëm dhe se në lëmin penale kjo çështje përbën *res judicata*.

Me administrimin e njoftimit me numër rendor 00000, i datës 02.07.2021, i lëshuar nga Departamenti-Zyra ligjore e K-it, për N.H, gjykata vërtetoi faktin se paditësja e ka ftuar të paditurin për marrëveshje për dëmin e supozuar nga ana e paditëses.

Me administrimin e kalkulimit RH, të lëshuar nga Sektori i Rikthimit të Humbjeve në K, gjykata vërtetoi faktin se energjia e shpenzimit të paautorizuar nga konsumatori N.H është 1719 KWh.

Me administrimin e faturës me numër DGJHP209002 të datës 17.01.2020, të lëshuar nga K, gjykata vërtetoi faktin se vlera totale e borxhit të të paditurit ndaj paditëses është 77.40 euro.

Baza juridike e kërkesëpadisë në këtë rast është vërtetuar nga aktgjykimi P.nr.320/2020, të datës 18.01.2021, i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, i cili është i plotfuqishëm nga data 30.08.2021, por meqenëse lartësia e kërkesëpadisë ka qenë kontestuese në këtë çështje juridike, ndërsa asnjëra nga palët nuk kanë propozuar nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmi i elektros, me të cilën do të vërtetohej lartësia e kërkesës, gjykata në seancën përgatitore të mbajtur më datën 05.06.2024 sipas detyrës zyrtare me aktvendim ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmi i elektros, i cili në këtë çështje do të kishte për detyrë që në ekspertizën e tij të bënte kalkulimin real të humbjeve sipas shkresave të lëndës. Prandaj, meqë gjykata ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë sipas detyrës zyrtare, në këtë rast e ka detyruar paditësen që në afatin prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, në llogarinë e arkës së kësaj gjykate të deponojë shumën prej 200.00 euro në emër të ekspertizës nga lëmi i elektros, ku është paralajmëruar se në rast se nuk e deponon shumën prej 200.00 euro, do të konsiderohet se ka hequr dorë nga nxjerrja e provës me ekspertizë nga lëmi i elektros. Meqenëse ka kaluar afati prej 15 ditëve nga dita kur gjykata e ka detyruar paditësen që ta deponojë shumën prej 200.00 euro në emër të ekspertizës nga lëmi i elektros dhe

paditësja nuk ka vepruar sipas aktvendimit të datës 05.06.2024, gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 30.07.2024 e ka revokuar aktvendimin e datës 05.06.2024, për nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmi i elektros. Sa i përket nxjerrjes së provës me ekspertizë sipas detyrës zyrtare, gjykata një vendim të tillë e ka marrë duke u bazuar në nenin 356 të LPK-së, i plotësuar me nenin 21 të Ligjit Nr. 04/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik, sipas të cilit *“Gjykata ex officio ose me propozimin e palëve mundë të bëjë të provuarit me anë të ekspertizës, sa herë që për vërtetimin apo sqarimin e fakteve, apo të rrethanave të caktuara nevojitet dijeni profesionale të cilën nuk e ka gjyqtari i çështjes”*. Ndërsa në rastin konkret gjykata e ka revokuar nxjerrjen e provës me ekspertizë për faktin se paditësja nuk i ka deponuar mjetet monetare në emër të ekspertizës duke u bazuar në nenin 451.3 të LPK-së, sipas të cilit *“Gjykata do të heqë dorë nga marrja e provës në qoftë se shuma e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve nuk deponohet në afatin e caktuar nga gjykata”*. Prandaj, meqenëse çështjet e ngritura nuk hyjnë në vërtetimin e fakteve nga neni 3.3 i LPK-së, barra e provave për vërtetimin fakteve që janë me rëndësi për nxjerrjen e të drejtës subjektive i bien paditësit.

Prandaj, meqenëse paditësja ka hequr dorë nga nxjerrja e provës me ekspertizë nga lëmi i elektros i cili ka qenë i nevojshëm dhe medoemos ta përpiloj dhe mbrojë ekspertizën e tij në këtë lëmi, për shkak se çështjet e paraqitura në këtë padi i tejkalojnë njohurinë që gjykata mund të ketë në këtë çështje, dhe nuk është vërtetuar lartësia e kërkesëpadsisë, gjykata ka vendosur që ta refuzoj në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses. Deri te ky vlerësim kjo gjykatë ka ardhur për faktin se barra e të provuarit të ekzistimit të ndonjë të drejte subjektive e cila buron nga e drejta objektive i takon parashtruesit të padisë, në këtë rast paditësit. Deri te ky vlerësim kjo gjykatë ka ardhur duke u bazuar në nenin 7.1 të LPK-së sipas të cilit *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Ndërsa në nenin 7.3 të LPK-së parashihet që *“Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen”*. Në rastin konkret, gjykata i ka cekur se cilat prova i ka administruar, mirëpo për ta vërtetuar lartësinë e kërkesëpadsisë, përveç provave të administruara ka qenë e nevojshme që të nxjerrët edhe prova me ekspertizë nga lëmi i elektros. Se barra e të provuarit i takon paditësit, parashihet edhe në nenin 322.1 të LPK-së, sipas të cilit *“Në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës”*. Ndërsa në nenin 322.2 të LPK-së parashihet që *“Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”*. Gjatë gjithë procedurës, gjykata i ka dhënë mundësi që palët ti paraqesin pretendimet dhe provat e tyre dhe meqë nuk ka mundur të provohet lartësia e kërkesëpadsisë, me provat që gjykata i kishte në disponim, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 357 par. 1 dhe par. 2 të LMD-së, nenit 7.1, 7.3, 8, 143, 322.1, 322.2, 356 dhe 451.3 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 463.2 dhe 463.3 të LPK-së.

Numri i lëndës: 2021:205694
Datë: 06.08.2024
Numri i dokumentit: 06025368

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.947/2021, me datë 30.07.2024

Gjyqtari
Berkan Hamza

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.